1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim AKKP), në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohet shpërblimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, njofton publikisht në media dhe/ose nëpërmjet faqes së vet zyrtare, listën e personave që përfitojnë nga fondi i kompensimit të pronave, për periudhën përkatëse.

2. Në njoftimin publik duhet të përcaktohen:

- a) gjenealogjia e përfituesit;
- b) periudha kohore e paraqitjes së kërkesës;
- c) dokumentacioni i nevojshëm shoqëruar i kërkesës;
- ç) vlera e tarifës së shërbimit;

d) detyrimi për subjektet përfituese për të hapur, në emër dhe për llogari të tyre, një llogari bankare në njërin nga bankat e nivelit të dytë.

3. Procesi i regjistrimit/pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së njoftimit publik dhe vazhdon për 30 (tridhjetë) ditë.

4. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së ngrihet grupi i punës për pranimin e shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, dhe shpërndarjen e fondit përkatës.

5. Kjo procedurë kryhet për çdo fond që i kalon AKKP-së sipas ligjit nr.10239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, dhe në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohet shpërblimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale. Kompensimi bëhet në masën e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, ku parashikohet shpërblimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale.

6. Subjekti apo përfaqësuesi me prokurë i tij, brenda afatit të përcaktuar në njoftimin publik, paraqet pranë zyrës së AKKP-së, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën për kompensimin e pronës sipas formatit tip, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit, për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie;

c) Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre;

ç) Vërtetimin e lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfituar;

d) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit, si dhe certifikatën familjare të kërkuarit;

d) Mandatpagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit.

7. AKKP-ja bashkëpunon me ALUIZNI-n dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për verifikimin e konfirmimin e të dhënave për subjektet përfituese.

8. Grupi i punës, sipas pikës 4 të këtij vendimi, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e kërkesës për kompensimin e pronës, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) Verifikon legjitimitimin e kërkuarit për çdo kërkesë për kompensimin e pronës;
- b) Kontrollon dokumentacionin e paraqitur nga subjekti përfitues;
- c) Konfirmon të dhëna të tjera të nevojshme pranë institucioneve përkatëse;
- ç) Harton relacionin, në të cilin i propozon Drejtorit të Përgjithshëm kalimin e shumës në numrin e llogarisë bankare përkatëse;
- d) Harton listën e subjekteve që kompensohen.

9. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, në përfundim të procesit të verifikimit nga grupi i punës,:

- a) nxjerr vendimin për miratimin e listës së subjekteve që kompensohen, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të derdhet vlera e kompensimit;
- b) urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen;
- c) njofton kërkuarin, që nuk përfshihet në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes.

10. AKKP-ja kryen veprimet me degën e thesarit dhe bankën e nivelit të dytë për derdhjen e shumës në depozitën bankare, të hapur për këtë qëllim nga subjekti përfitues, në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

11. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, AKKP-ja realizon ndarjen e fondit aktual të kompensimit të pronave në vlerë proporcionale me masën përkatëse të parashikuar në listat bashkëlidhur vendimeve, të miratuara deri më tani.

12. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËRKESË

PËR KOMPENSIMIN E PRONËS

Drejtuar: AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, TIRANË

Data e paraqitjes së kërkesës: ____/____/2010

Subjekti përfitues:

Emri Atësia Mbiemri

Përfaqësuesi me prokurë i subjektit përfitues, që paraqet kërkesën:

Emri Atësia Mbiemri

Adresa e subjektit përfitues ose e përfaqësuesit të tij me prokurë:

Qarku Qyteti Fshati

Lagjia Rruga Numri i banesës

Telefon Celular e-mail

Në përputhje me nenin 15/1 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neneve 5 dhe 6 të ligjit nr.10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr._____, datë ____/____/, kërkoj kompensimin e pasurisë së paluajtshme, që preket nga ndërtimet informale.

Në listën bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr._____, datë ____/____/_____, mbaj numrin rendor _____.

Kërkuesi

(emri,atësia,mbiemri)

Shënim: Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedurë të mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.

VENDIM
Nr.384, datë 19.5.2010

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.830, DATË 11.12.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAJISJEN E PUNONJËSVE TË GARDËS
SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË ME ARMATIM DHE MJETE TEKNIKE TË
POSAÇME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.8869, datë 23.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.830, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 1 shtohen pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7, me këtë përmbajtje:

“2. Afatet e përdorimit të armatimit dhe të mjeteve teknike të posaçme, sipas tabelave nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, bashkëlidhur vendimit, si dhe rregullat e trajtimit të tyre pas heqjes nga përdorimi, pas përfundimit të afatit kohor të përdorimit, përcaktohen në rregulloren, që miratohet me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

3. Për mjetet teknike të posaçme specifike, helikopter, evakuues (transportues) dhe motoskaft, afatet e përdorimit përcaktohen në tabelën nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Pas përfundimit të afateve të përdorimit, këto mjete hiqen nga përdorimi me urdhër të autoritetit përkatës, si më poshtë vijon:

- Për helikopterët, nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Brendshëm;

- Për motoskaftët dhe evakuesit (transportuesit), nga Ministri i Brendshëm, me propozimin e komandantit të Gardës.

4. Mjetet teknike të posaçme, specifike, të përfshira në pikën 3 të këtij vendimi, që hiqen nga përdorimi në Gardën e Republikës, pas përfundimit të afateve të përdorimit sipas përcaktimit në tabelën nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi, por që kanë vlera përdoruese në gjendjen që janë, lejohen të shiten, sipas legjislacionit në fuqi. Ndërsa ato që nuk kanë vlera përdoruese lejohen t'u nënshtrohen procedurave të asgjësimit, demilitarizimit dhe tjetërsimit të pronës shtetërore, nga ndërmarrje shtetërore të specializuara në kryerjen e proceseve të tilla, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Të ardhurat, që do të realizohen nga shitjet, sipas pikës 4 të këtij vendimi, do të derdhen në llogarinë buxhetore, të ardhura nga institucionet buxhetore në bankat e nivelit të dytë, dhe përdoren sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet e Ministrisë së Brendshme”, nxjerrë në zbatim të vendimit nr.432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

6. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.”.

b) Pika 2 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**AFATET E PËRDORIMIT PËR DISA MJETE TEKNIKE TË POSAÇME
NË GARDËN E REPUBLIKËS**

I.	EVAKUES (Transportues)	Jetëgjatësia në vite	Jetëgjatësia në orë pune
1.	Transportues i blinduar me zinxhirë (TRBL)	30 vjet	750 moto/orë
2.	Tank model 59	35 vjet	750 moto/orë
II.	MJETE AJRORE		
1.	Helikopter	35 vjet	Përcaktohet nga uzina prodhuese

VENDIM

Nr.385, datë 19.5.2010

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.538, DATË 26.5.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LICENCAT DHE LEJET QË TRAJTOHEN NGA APO NËPËRMJET
QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE DISA RREGULLIME TË TJERA
NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15, pikat 1 e 2, shkronja “a” e 36 të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë“, dhe të nenit 66 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Pas aneksit 3, që i bashkëlidhet vendimit nr.538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet aneksi 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Kërkesat për licenca, leje, autorizime, certifikata dhe për çdo akt tjetër administrativ, që lidhet me veprimtaritë e përcaktuara në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, trajtohen sipas aneksit 4, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.

3.Licencimi i projekteve energjetike sipas aneksit 4 fillon më 9.6.2010.

4.Subjektet zhvilluese të veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, që kanë bërë kërkesa për licenca, leje, autorizime, certifikata apo akte të tjera administrative, konkrete, para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, vendosin vetë, nëse do të vazhdojnë procedurën e nisur apo do të rinisin procedurën sipas këtij vendimi për njërën apo disa nga kërkesat.

5.Vendimi nr.913, datë 26.8.2009 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Qendrës Kombëtare për Aplikimet Energjetike”, shfuqizohet.

6.Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Qendra Kombëtare e Licencimit të marrin të gjitha masat për nisjen e procesit të licencimit sipas aneksit 4, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 9.6.2010.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

ANEKSI 4 PËR LICENCIMIN NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

1. Licencimi në kuptim të këtij aneksi përfshin licenca, leje, autorizime, certifikime dhe çdo akt tjetër administrativ që lidhet me veprimtari në sektorin e energjisë elektrike.

2. Kur kërkesa për licencim lidhet me një nga kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave sipas aneksit I të këtij vendimi, ajo trajtohet nga QKL, sipas procedurave përkatëse.

3. Kur kërkesa lidhet me një nga kategoritë dhe/ose nënkategoritë e licencave sipas aneksit II të këtij vendimi, apo kur është një autorizim, certifikim a një akt tjetër administrativ në kompetencë të institucioneve qendrore ajo trajtohet sipas procedurave të grupit III të licencave. Kriteret, procedurat dhe afatet e shqyrtimit të kërkesës nga institucioni qendror përgjegjës janë ato të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Parimi i miratimit në heshtje zbatohet vetëm kur ky është parashikuar shprehimisht në legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Kur kërkesat për licencim lidhen me kompetenca të institucioneve të pavarura, ajo bëhet drejtpërdrejt në institucionin përkatës, i cili e shqyrton atë sipas legjislacionit në fuqi. Parimi i miratimit në heshtje zbatohet vetëm kur ky është parashikuar shprehimisht në legjislacionin përkatës në fuqi. QKL verifikon nëse këto institucione shpallin në regjistër kërkesat dhe vendimet e marra për to. Kërkuesi mund të njoftojë dhe dokumentojë pranë QKL-së kërkesën e bërë pranë një institucioni të pavarur. Me marrjen e njoftimit nga regjistri dhe/ose nga kërkuesi, QKL ndjek, nxit e lehtëson procesin e trajtimit të kërkesës nga institucioni i pavarur përgjegjës.

5. Kërkuesi zgjedh vetë nëse do të bëjë kërkesë në grup, një e nga një, kërkesë me një apo më shumë faza, si dhe radhën e bërjes së kërkesave. QKL këshillon kërkuesit për mënyrën më të përshtatshme të kryerjes së kërkesave sipas specifikave të veprimtarisë konkrete.

6. Për çdo veprimtari konkrete në sektorin e energjisë elektrike, QKL krijon një dosje të veçantë në regjistër me të gjitha kërkesat e lidhura me këtë veprimtari konkrete.

7. QKL lehtëson procesin e shqyrtimit të kërkesave edhe nëpërmjet komunikimeve, takimeve individuale apo në grup me institucionet e tjera përgjegjëse qendrore apo të pavarura, si dhe informon ministrin dhe Kryeministrin, lidhur me ecurinë e procesit të licencimit të çdo projekti energjetik.

8. Në rastin e veprimtarive që kushtëzohen nga lidhja e një kontrate koncesionare, pikat e mësipërme të këtij aneksi zbatohen pas lidhjes së një kontrate të tillë.

9. QKL këshillon ministrin dhe institucionet e tjera me rol në një procedurë koncesionare me qëllim që kriteret e garës dhe kontrata koncesionare të shërbejnë, për aq sa është e përshtatshme, edhe për ezaurimin automatik të sa më shumë kriterëve e procedurave që lidhen me licencimin pas lidhjes së një kontrate të tillë.

VENDIM
Nr.386, datë 19.5.2010

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS NDËRKOMBËTARE TË
ARBITRAZHIT PËR ÇËSHTJEN NR.14403/FM GENERAL ELECTRICS, ATHENA
(ILIRIA CONSORTIUM) VS MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 10 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, në Romë, Itali, për çështjen nr.14403/FM General Electrics, Athena (Iliria Consortium) vs Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në vlerën 11 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) euro, vlerë për të cilën është rënë dakord sipas marrëveshjes së negociimit me General Electrics, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t'i shtohen fondet përkatëse për kryerjen e pagesës së vlerës sipas pikës 1 të këtij vendimi, dhe procedura e ekzekutimit të jetë në përputhje me marrëveshjen e negociimit, ndërmjet GE Transportation System S.p.a. dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

3. Detyrimi financiar i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga Buxheti i Shtetit, fondi i kontingjencës.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE NEGOCIMI

Ndërmjet

1.Republika e Shqipërisë, duke vepruar përmes Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për këtë çështje, e përfaqësuar nga z.Ernest Noka, zëvendësministër i Punëve Publike dhe Transportit (këtu e më poshtë referuar si “Shqipëria”);

dhe

2.Ge Transportation Systems sh.p., me zyrën e saj të regjistruar në Via P.Fanfani 21, 50127, Firenze, Itali, për këtë çështje e përfaqësuar nga z.Pierre Comte (këtu e më poshtë referuar si “GETS”);

3.Athena SH.A me zyrën e saj të regjistruar në 357-359 Av.Messogion, 15231, Athinë, Greqi për këtë çështje e përfaqësuar nga z.Pierre Comte, duke vepruar për dhe në emër të Athena në bazë të një prokure të datës 4 maj 2010 të lëshuar nga z.Konstatinos Mitzalis në emër të Athena (këtu e më poshtë referuar si “Athena”);

(Palët 2 dhe 3 më poshtë të referuara së bashku si “Iliria Consortium” apo “Kreditorët” ose “GETS-Athena” dhe të palëve 1,2 dhe 3 më poshtë të referuara së bashku si “Palët” ose “palët”)

ndërsa:

A) Më 15 shtator 2003 Iliria Consortium dhe Republika e Shqipërisë, duke vepruar përmes Ministrisë së saj të Transportit dhe Telekomunikacionit (“Shqipëria”), lidhi një kontratë (“Kontrata”), për modernizimin e segmenteve Tiranë-Durrës dhe për në Aeroportin e Rinasit.

B) Një mosmarrëveshje lindi ndërmjet Iliria Consortium dhe Shqipërisë në lidhje me shkëljen e deklaruar të detyrimit sipas kontratës nga Shqipëria. Mosmarrëveshja u zgjidh në një gjykatë arbitrazhi ICC, (“Gjykata”), sipas rregullave të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit ICC, në Romë, Itali. Gjykata dha një vendim jopërfundimtar më 1 tetor 2007 dhe një vendim përfundimtar më 28 korrik 2008 (“Vendimi”) duke i akorduar pjesërisht të drejtën Iliria Consortium në lidhje me kërkesën për dëmshpërblim.

C) Në nëntor 2008 Shqipëria nisi procedurat gjyqësore për anulim të vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit në Romë, Itali. Me qëllim ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, kreditorët filluan që nga marsi i 2009 veprimet e ekzekutimit të detyruar në juridiksione të ndryshme. Ndër të tjera, kreditorët bllokuan fonde të pagueshme për Shqipërinë nga Eurocontrol në Belgjikë deri në një shumë prej 16 918 716,86 euro deri më 30 prill 2010.

D) Palët hynë në diskutime për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe negociuan një zgjidhje të plotë për të gjitha mosmarrëveshjet, pretendimet dhe pretendimet e mundshme të tyre që lindën në lidhje me kontratën dhe vendimin dhe tani dëshirojnë ta konfirmojnë këtë Marrëveshje negociimi, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara këtu.

Duke marrë parasysh sa më sipër palët me anë të kësaj deklarojnë dhe bien dakord si vijon:

Marrëveshje e përgjithshme

1. Shqipëria është në dijeni të vendimit dhe gjykimit në SHBA, dhe se në bazë të tij i detyrohet kreditorëve një shumë prej 16 633.500 euro (USD 21 986,870.63) që do të rritet sipas një interesi ligjor në Amerikë në përputhje me statutin 28 USC 1961, që prej 16 marsit 2010.

Shuma e pranuar për t’u paguar

2. Shqipëria bie dakord t’u paguajë kreditorëve një shumë prej 11 000 000 euro (njëmbëdhjetë milionë, “Shuma e pranuar”). Pagesa e shumës së pranuar do të jenë në euro në një pagesë me transfertë në llogarinë bankare të treguara nga GETS-Athena. Pagesa do të kryhet si vijon: 11 000 000 euro (njëmbëdhjetë milionë) deri në 10 qershor 2010.

Pezullimi i procedurave gjyqësore të lëna pezull

3. Me ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje negociimi, palët menjëherë do të bashkëpunojnë dhe të udhëzojnë këshilltarët e tyre ligjorë përkatës në mënyrë që të pezullojë procedurat gjyqësore të mbetura pezull në gjykatat e Holandës, Belgjikës, Qipros, Greqisë, SHBA-së, Zvicrës dhe Gjermanisë. Përveç kësaj GETS-Athena zotohet të mos iniciojë ndonjë procedurë tjetër ekzekutimi mbi asetet e Shqipërisë.

Heqja e procedurave të përmbarrimit dhe përfundimi i procedurave gjyqësore të lëna pezull

4. Pas marrjes së shumës së pranuar, GETS-Athena do të udhëzojë Altius Avocats të urdhërojnë heqjen e menjëhershme të bllokimit të llogarive të Eurocontrol. Secila nga palët, menjëherë pas ekzekutimit të heqjes së bllokimit të llogarive të Eurocontrol, do të udhëzojnë avokatët e tyre përkatës për të anuluar, tërhequr dhe/ose ndërprerë çdo dhe të gjitha (ligjore) procedurat që janë iniciuar para gjykatave në Itali, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zvicër, Holandë, Belgjikë, Gjermani, Qipro dhe Greqi. Çështja gjyqësore pezull në Gjykatën e Apelit të Romës RG 10644/2008 do të mbyllet sipas nenit 309 të Kodit të Procedurës Civile Italiane, secila palë duke mbuluar shpenzimet dhe tarifat e veta.

Shkelja

5. Në rast se Shqipëria nuk arrin ta paguajë shumën e pranuar, në përputhje me nenin 2 më lart, GETS-Athena, në diskrecion të tyre, do të ketë të drejtën për ta zbatuar këtë marrëveshje ose për ta përfunduar atë dhe të ndjekin të drejtat e tyre sipas vendimit dhe kontratës. Asgjë në këtë marrëveshje negociimi nuk mund të interpretohet ose të shpjegohet si heqje dorë nga të drejtat e GETS-Athena sipas vendimit, kontratës dhe të çfarëdo të drejte tjetër të arritur në juridiksione të ndryshme ku zbatimi i vendimit është iniciuar. Përveç kësaj dhe për të shmangur çdo keqkuptim, GETS-Athena nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga një procedurë sekuestroje, as të heqë dorë nga çdo procedurë përmbarrimore dhe Shqipëria me anë të kësaj shprehimisht ka dijeni se kreditorët do të kenë të drejtën për të vazhduar zbatimin e të gjitha të drejtave të tyre sipas vendimit dhe veprime të tjera (të zbatimit) siç përshkruhet më lart.

Negocimi i plotë dhe përfundimtar

6. Vetëm pas marrjes së shumës së pranuar dhe heqjes së bllokimit të llogarive të Eurocontrol, Shqipëria dhe kreditorët angazhohen dhe bien dakord reciprokisht për lirimin dhe shkarkimin e njëri-tjetrit si dhe të agjentëve, zyrtarëve, punonjësve dhe bashkëpunëtorëve të tyre respektivë të tanishëm apo ish, nga të gjitha pretendimet, detyrimet, dëmet, kostot, tarifat e avokatit dhe shpenzimet, si dhe nga të gjitha pretendimet, veprimet, shkaqet e veprimeve dhe padive (referuar këtu e më poshtë si "Pretendimet") që rrjedhin nga ligji apo drejtësia, kontrata ose detyrimet, parashikuar apo të paparashikuara, për çfarëdolloj arsyesh, shkakut, veprimi ose mosveprimi, çfarëdoqoftë, pretendime të cilat një palë ka tani, ka pasur ose mund të ketë kundrejt palës tjetër sipas ose në lidhje me kontratën, vendimin ose procedurat gjyqësore pranë gjykatave të Italisë, Zvicrës, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Holandës, Belgjikës, Gjermanisë, Qipros dhe Greqisë, përveç për qëllimin e zbatimit të ndonjë të drejte sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje negocimi si dhe të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara nga neni 1 - neni 5 e më lart.

Konfidencialiteti

7. Kjo marrëveshje negocimi do të trajtohet nga palët si rreptësisht konfidenciale, nuk do të zbulohet para ndonjë pale të tretë, përveç avokatëve, konsulentëve apo këshilltarëve të palëve në rastet kur lind nevoja për të mësuar diçka (p.sh. për ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje negocimi) ose siç kërkohet me ligj.

Kostot dhe shpenzimet

8. Çdo palë mbulon tarifat dhe shpenzimet e veta në lidhje me procedurat gjyqësore italiane, amerikane, holandeze, gjermane, qipriote, greke, zvicerane dhe belge, tërheqjen e tyre dhe kostot, tarifat dhe shpenzimet e bëra në lidhje me negocimin, përgatitjen dhe përfundimin e kësaj marrëveshjeje negocimi, dhe me përmbushjen e detyrimeve në lidhje me këtë marrëveshje negocimi.

Amendimet

9. Kjo marrëveshje negocimi mund të ndryshohet ose të modifikohet vetëm nga një marrëveshje me shkrim të kryer siç duhet nga të gjitha palët.

Autoriteti për të negociuar

10. Palët shprehimisht paraqesin dhe autorizojnë që ekzekutimi dhe plotësimi i detyrimeve të tyre përkatëse, sipas kësaj marrëveshjeje negocimi, është plotësisht i autorizuar nga secili prej tyre dhe se personat për zbatimin e kësaj marrëveshjeje kanë autoritetin e duhur dhe të nevojshëm për ta bërë këtë.

GETS-Athena me anë të kësaj konfirmon se e kupton se kjo marrëveshje negocimi do të duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Shqipëria megjithatë konfirmon se një autorizim i tillë në asnjë rast nuk do të vonojë pagesën e shumës së pranuar deri pas 10 qershorit 2010.

Ligji dhe juridiksioni

11. Kjo marrëveshje negocimi do të udhëhiqet nga dhe interpretohet në përputhje me ligjin material të Italisë, ekskluzive e rregullave të Conflicts of Laws. Çdo mosmarrëveshje, kundërshti ose pretendim që mund të lindë nga apo në lidhje me këtë marrëveshje negocimi ose ekzekutimi, shkelja, përfundimi ose pavlefshmëria e tij do të zgjidhet në përputhje me klauzolën e arbitrazhit të dhënë në kontratë.

Data e zbatimit

12. Kjo marrëveshje negocimi është e vlefshme që prej 6 maj 2010 ("Data e zbatimit").

13. Kjo marrëveshje negocimi është hartuar në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast të mospërputhjes ose kontradiktave ndërmjet versionit anglisht dhe shqip, versioni anglisht do të ketë përparësi.

Nënshkruar në tri kopje në emër të GE Transportation System S.p.A Firenze, Itali:

Titulli

z.Perre Comte

Datë: 6 maj 2010

Nënshkruar në tre kopje në emër të Athena S.A., Athinë, Greqi
Titulli:
z.Pierre Comte
Datë: 6 maj 2010

Nënshkruar në tri kopje në emër të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri
Titulli:Zëvendësministër i Punëve Publike dhe Transportit z.Ernest Noka
Datë: 6 maj 2010

VENDIM
Nr.387, datë 13.4.2010

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE,
NGA MINISTERIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
DHE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE, TE FONDI SHQIPTAR I
ZHVILLIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:



1. Mjediseve, që janë në përdorim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, përkatësisht katet përdhe, i dytë, i tretë e i katërt të ndërtesës, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, sipas genplanit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.



2. Mjediseve, që janë në përdorim të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, përkatësisht, kati i parë i ndërtesës, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të Fondi Shqiptar i Zhvillimit, dhe këto mjedise t’i jepen në përdorim Zyres së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.


3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha







VENDIM
Nr.388, datë 19.5.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.71, DATË 3.2.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOQSHME, PËR VITIN 2010, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.71, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2010, në njësitë e qeverisjes qendrore, është 1006 punonjës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2010, për njësitë e qeverisjes qendrore.

3. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë përcaktimin e numrit të punonjësve, sipas lidhjes nr.1, të përmendur në pikën 1, në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3989

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare	Muajt
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	24			
	Aparati i Ministrisë	1	Sanitare	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	1	Operatore	deri 5 orë/ditë	vjetore
	Inspektoriati Qendror Teknik	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Inspektoriati Qendror Teknik	1	Punëtorë mirëmbajtjeje në laborator	deri 5 orë/ditë	vjetore
	ALBINVEST	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Shërbimi Gjeologjik	2	Punëtor shpimi	3-5 orë/ditë	vjetore
	Shërbimi Gjeologjik	1	Punëtor rievimi	3-5 orë/ditë	vjetore
	Shërbimi Gjeologjik	11	Nëpunës roje	8 orë/ditë	5 muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	5	Punëtorë	3-4 orë/ditë	7 muaj
05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	201			
	QTTB në F. Krujë/Lushnjë/Shkodër/Vlorë/Korçë	175	Punëtorë blegtorie/fushe/mekanzat or/roje E bazës eksperimentale	8 orë/ditë	6 muaj
	Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve	12	Punëtor fushe	4 orë/ditë	Maj-dhjetor
	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidaneve	2	Teknikë	4 orë/ditë	Maj-dhjetor
	DBRUK	12	Punonjës dezinfektimi	8 orë/ditë	2 muaj
06	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	502			
	ALUIZNI	500	Specialistë/ndihmëspecialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Ujësjellës Kanalizimeve	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
	IQT	1	Sanitar	deri 4 orë/ditë	vjetore
10	Ministria e Financave	28			
	Spektori i pagesave të dëmshpërblimeve	4	Specialiste	8 orë/ditë	6 muaj
	Spektori i pagesave të dëmshpërblimeve	1	Punonjës arkive	8 orë/ditë	6 muaj
	Drejtoria e Financimeve, Kontraktimeve/dega thesarit T	1	Roje	8 orë/ditë	6 muaj
	Drejtorinë e Përgjithshme Financimeve dhe Kontraktimeve	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Degët e thesarit	7	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	4	Operatore	deri 4 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Elbasan	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Morinë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Shkodër	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Kakavijë Gjirokastër	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Vlorë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Tiranë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Tushemisht	1	Sanitare	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Qafë-Thanë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Tre-Urat Përmet	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	6			
	ZAK Butrint	5	Ciceronë	8 orë /ditë	4.5 muaj
	ZAK Butrint	1	Punëtor mirëmbajtjeje	8 orë /ditë	4.5 muaj
13	Ministria e Shëndetësisë	6			
	Spitali Psikiatrik Elbasan	3	Kaldaistë	8 orë /ditë	4.5 muaj
	Drejtoria e Shëndetit Publik Vlorë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë /ditë	Mars-dhjetor
	Drejtoria e Shëndetit Publik Peqin	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë /ditë	Mars-dhjetor
	Drejtoria e Shëndetit Publik Has	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë /ditë	Mars-dhjetor
15	Ministria e Jashtme	10			
	Aparati i Ministrisë	2	Punëtorë mirëmbajtjeje	6 orë /ditë	vjetore
	Spektori i legalizimeve	5	Preparatorë	6 orë /ditë	vjetore
	Spektori i arkivit	3	Arkivistë	6 orë /ditë	vjetore
16	Ministria e Brendshme	136			
	Aparati	1	Specialist përkthyes	8 orë/ditë	6 muaj
	Aparati	2	Teknikë	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	2	Kuzhinier	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	4	Ndihmëskuzhinier	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	2	Kamarierë	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Punëtor restoranti	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	4	Punëtorë hoteli	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Receptionist	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Elektracist	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Hidraulik	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Punëtor gjelbërimi	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Lavateri	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	4	Kuzhinier	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	4	Ndihmëskuzhinier	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	27	Kamarierë	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator

	Shtëpia e pushimit Durrës	7	Punëtorë kuzhine	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	7	Punëtorë restoranti	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	25	Punëtorë hoteli	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	3	Receptionist	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Elektriciist	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Hidraulik	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	2	Punëtor gjelbërimi	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Lavanderi	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Rezervat materiale të shtetit	20	Roje	8 orë/ditë	6 muaj
	Rezervat materiale të shtetit	5	Punëtorë magazine	8 orë/ditë	6 muaj
	Qendra e Formimit Policor	2	Sanitar	8 orë/ditë	5 muaj
	Qendra e Formimit Policor	2	Ndihmëskuzhinier	8 orë/ditë	5 muaj
	Qendra e Formimit Policor	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	5 orë/ditë	5 muaj
	Qendra e Formimit Policor	3	Kuzhinier	8 orë/ditë	5 muaj
18	Shërbimi Informativ i Shtetit	36			
	Shërbimi Informativ i Shtetit	5	Sanitar	3-4 orë/ditë	vjetore
	Shërbimi Informativ i Shtetit	1	Sanitar	3-4 orë/ditë	6 muaj
	Shërbimi Informativ i Shtetit	8	Kuzhinier	8 orë/ditë	3 muaj
	Shërbimi Informativ i Shtetit	4	Banakier	8 orë/ditë	3 muaj
	Shërbimi Informativ i Shtetit	18	Pastruese	8 orë/ditë	3 muaj
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	10			
	Aparati	10	Administratore dokumentesh	5 orë/ditë	vjetore
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	35			
	Aparati	4	Roje	8 orë/ditë	4 muaj
	Në institucionet e shtëpisë së foshnjes/fëmijëve/moshuarve/qendrat e zhvillimit/qendrat pritëse dhe ditore	21	Mjekë	deri 4 orë/ditë	vjetore
		10	Sanitar	deri 4 orë/ditë	vjetore
28	Prokuroria e Përgjithshme	9			
	Aparati	2	Përkthyes	5 orë/ditë	vjetore
	Prokuroria Tiranë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Prokuroria Durrës	1	Sanitar	3-4 orë/ditë	vjetore
	Prokuroria e Apelit për Krimet e rënda	1	sanitar	3-4 orë/ditë	vjetore
	Aparati	4	Përkthyes	8 orë/ditë	4 muaj
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	1			
	Aparati	1	Stenograf	5 orë/ditë	9 muaj
77	Autoriteti i Konkurrencës	2			
	Autoriteti i Konkurrencës	1	Teknik mirëmbajtjeje	5 orë/ditë	vjetore
	Autoriteti i Konkurrencës	1	Sanitar	3-4 orë/ditë	vjetore
	Total numri i punonjësve	1006			

VENDIM
Nr.392, datë 19.5.2010

PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË “GJON BUZUKU”, SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës private të arsimit të lartë “Gjon Buzuku”, Shkodër, e cila do të ushtrrojë veprimtarinë në qytetin e Shkodrës.

2. Shkolla private e arsimit të lartë “Gjon Buzuku”, Shkodër do të organizohet në dy fakultete:

a) Fakulteti i Drejtësisë, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në “Drejtësi”.

b) Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, që do të ofrojë programin e studimit të ciklit të parë në “Informatikë”.

3. Shkolla private e arsimit të lartë “Gjon Buzuku”, Shkodër do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tri) vite akademike dhe me plotësimin e, së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:

- a) Drejtësi;
- b) Informatikë.

4. Shkolla private e arsimit të lartë “Gjon Buzuku”, Shkodër ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi e programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla private e arsimit të lartë “Gjon Buzuku”, Shkodër duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 29.6.2010

Doli nga shtypi më 30.6.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë